



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË**  
**DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE  
SIGURISË PUBLIKE

Nr.734/5 prot.

Tiranë, më 05.05.2025

**REKOMANDIM**

**Nr. 23, datë 05.05.2025**

**PËR KONTROLLUESIN “INSTITUTI I MJEKËSISË LIGJORE”**

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”<sup>1</sup> (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Instituti i Mjekësisë Ligjore” (në vijim, “Kontrolluesi ose IML”),

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 33, datë 20.02.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. IML është institucion publik, buxhetor, në varësi të Ministrit të Drejtësisë, i cili e shtrin veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Objekt i veprimtarisë së IML, është mbështetja e organeve të drejtësisë dhe institucioneve të tjera publike për zgjidhjen e çështjeve hetimore dhe gjyqësore, me karakter mjekësor

---

<sup>1</sup>Ligji aktual në fuqi, i cili shfuqizon ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Për këtë arsye, orientojmë të gjithë subjektet e ligjit, të përditësojnë bazën ligjore në të gjitha aktet rregullatore.

e biologjik, në veprimtarinë kriminale dhe konfliktet civile, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve që përfshihen në funksionet administrative të këtij institucioni.

Kontrolluesi, bazuar në VKM nr. 680, datë 02.09.2020 *“Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Institutit të Mjekësisë Ligjore”*, legjitimohet të përpunojë të dhëna personale, për kategoritë *“punonjës”*, *“ekspertë”* dhe *“persona objekt ekspertimi”*.

Rezulton se, Kontrolluesi, në funksion të veprimtarisë së tij, përpunon të dhëna personale dhe të dhëna sensitive, pjesë të dosjeve të akt-ekspertimeve që kryhen nga ekspertët e IML. Kontrolluesi përpunon të dhëna personale, sipas kategorive: *“Emër”*, *“Atësia”*, *“Mbiemër”*, *“Data e lindjes”*, *“Nr. i identifikimit”*, *“Gjinia”*, *“Vendlindja”*, *“Shtetësia”*, *“Adresa”*, *“Dëshmi aftësie për punë”*, si dhe të dhëna sensitive, të tilla si: *“Kartela shëndetësore”*, *“Përgjegjshmëria psikike”*, *“Analiza gjaku”*, *“Gjendja seksuale”*, *“Sekrecione biologjike”* dhe *“Materiale gjenetike”*.

Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike të administruara në format *“excel”*.

2. Kontrolluesi ka vënë në dispozicion të grupit të hetimit administrativ, rregulloren *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, miratuar me Urdhrin nr. 4420/2 prot., datë 20.12.2022. Referuar gurmës *“c”*, të nenit 4 të rregullores *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, përcaktohet se *“subjekt i të dhënave është çdo person fizik që i përpunohen të dhënat personale për përmbushjen e qëllimit të ligjit nr. 12/2018”*.

Për sa më sipër, rezulton se, subjektet e tjera të të dhënave personale, si: punonjës, persona objekt ekspertimi, etj., të ndryshëm nga subjektet e përcaktuara në ligjin nr. 12/2018, nuk identifikohen në rregullore, si dhe për kategoritë e tyre të të dhënave personale nuk janë hartuar rregulla dhe procedura organizative specifike, mbi mënyrën e përpunimit, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, nivelet e aksesit etj., si një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 28 të Ligjit dhe Vendimit nr. 6, datë 05.08.2013 *“Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”* (në vijim, *“Vendimi nr. 6”*), me qëllim shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Gjithashtu, referuar pikës *“5”*, të nenit 12 *“Masat për sigurinë e të dhënave”*, nenit 15 *“Masat e sigurisë së sistemeve elektronike”* dhe nenit 16 *“Përdorimi i programeve”* të rregullores *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, përcaktohet se Kontrolluesi aplikon programe dhe sisteme elektronike me qëllim kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në rregullore.

Referuar deklarimeve verbale të përfaqësuesve të Kontrolluesit, si dhe provave të administruara gjatë hetimit administrativ, rezulton se nga ana e IML nuk administrohet asnjë sistem elektronik, sipas përcaktimeve të bëra në rregullore dhe se e vetmja mënyrë përpunimi e të dhënave personale, është ajo manuale, në përgatitjen e dosjeve fizike të personave objekt ekspertimi.

Për sa më sipër, rezulton se, Kontrolluesi, në rregulloren “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, parashikon rregulla të përgjithshme dhe jo direkt të aplikueshme, lidhur me programet dhe sistemet elektronike që përdor gjatë veprimtarisë së tij, duke mos parashikuar në të, rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, IML duhet të përditësojë dhe mirëpërcaktojë proceset përpunuese dhe mënyrën e përpunimit të dhënave personale (konkretisht, në pikën 5, të nenit 12 “*Masat për sigurinë e të dhënave*”, nenin 15 “*Masat e sigurisë së sistemeve elektronike*”, si dhe nenin 16 “*Përdorimi i programeve*” të rregullores “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, ku përshkruhen procese përpunimi të të dhënave, të cilat nuk gjejnë zbatim konkret në objektin e aktivitetit të Kontrolluesit), në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit.

Lidhur me sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, është i nevojshëm rishikimi i rregullores “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*” dhe përshtatja e dispozitave të saj, në mënyrë të tillë që, në të të parashikohen të gjitha kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që bëjnë pjesë në proceset përpunuese të IML. Gjithashtu, në këtë rregullore duhet të parashikohen në mënyrë të detajuar rregulla dhe procedura mbi kategoritë e të dhënave personale që përpunohen, mënyrën e përpunimit, masat e sigurisë dhe konfidencialitetit, afatet e ruajtjes, të drejtat e subjekteve të të dhënave, si dhe përcaktimin e niveleve të aksesit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit dhe në zbatim të nenit 28 të Ligjit.

3. Gjithashtu, rezulton se, të dhënat sensitive (të dhëna gjenetike dhe të lidhura me shëndetin) të subjekteve të ekspertimit që trajtohen nga Kontrolluesi, nuk identifikohen në rregullore dhe aktet e brendshme të IML, si dhe për këtë kategori të të dhënave personale nuk janë hartuar rregulla dhe procedura organizative specifike, mbi mënyrën e përpunimit të tyre, sigurinë, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, nivelet e aksesit etj., si një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 28 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Të dhënat sensitive të administruara nëpërmjet kartelave, akt-ekspertimeve dhe çdo dokumentacioni tjetër shëndetësor, ruhen në ambientet e zyrës së arkivit, duke mos marrë, midis të tjerash, masa organizative dhe fizike, si një kategori e veçantë, të cilës duhet t’i sigurohet mbrojtje e dyfishtë dhe vëmendje e shtuar për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e tyre, në përputhje me nenin 28 të Ligjit, si dhe nenin 5 dhe 8 të Udhëzimit nr. 49, datë 02.03.2020 të Komisionerit “*Për mbrojtjen e të dhënave personale shëndetësore*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 49*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi është i detyruar të marrë masa shtesë të sigurisë së përpunimit për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të parashikojë

rregulla të veçanta për këtë kategori të të dhënave personale në rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në përputhje me nenin 28 të Ligjit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të dhënave sensitive. Mungesa e rregullimit të qartë për këto kategori të dhënash përbën cenim për përpunimin e ligjshëm, të drejtë dhe transparent të të dhënave personale.

Për shkak të natyrës së tyre të ndjeshme, Kontrolluesi duhet të hartojë rregulla dhe procedura organizative specifike për këtë kategori të të dhënave personale, në lidhje me mënyrën e përpunimit dhe sigurinë e tyre, në përputhje me nenin 28 të Ligjit dhe nenet 5 e 8 të Udhëzimit nr. 49 të Komisionerit.

4. Kontrolluesi ka të instaluar sistemin e video survejimit CCTV, përmes së cilit kryen mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme ku ushtron veprimtarinë e tij, për qëllim të mbrojtjes së pronës dhe sigurinë e kontrollit mbi hyrjet dhe daljet.

Nga verifikimet e kryera në sistemin e video survejimit CCTV, rezulton se të dhënat imazhe/video, ruhen përtej afatit dy mujor (datë 14.11.2024), në kundërshtim me parimin e ruajtjes në kohë, sipas pikës 5, të nenit 6 të Ligjit dhe pikës 4/c, të Udhëzimit nr. 3, datë 05.03.2010 të Komisionerit “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 3”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është edhe sistemi i video survejimit CCTV. Të dhënat e ruajtura në këto sisteme, si: “imazhe” e “video”, janë të dhëna personale dhe përpunimi i tyre duhet të jetë në përputhje me parashikimet e Ligjit, si dhe aktet e miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Për këtë arsye, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi mund të përpunojë të dhënat e subjekteve të të dhënave nëpërmjet sistemit të video survejimit CCTV, për aq kohë sa ekziston qëllimi i ligjshëm, për të cilin ato janë grumbulluar. Në momentin që qëllimi ka përfunduar, IML, duhet të realizojë shkatërrimin e të dhënave të përpunuara përmes sistemit CCTV, referuar parashikimit të pikës 5, të nenit 6 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm.

Gjithashtu, lidhur me këtë proces përpunues, Zyra e Komisionerit vlerëson se, nga shqyrtimi i dokumentacionit provues të vendosur në dispozicion, Kontrolluesi nuk ka miratuar rregulla/politika të brendshme specifike, për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video survejimit CCTV, nivelet e aksesit, afatet e ruajtjes së të dhënave, etj., në kundërshtim me Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit.

Për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi është i detyruar të hartojë rregulla/politika të brendshme specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, nivelet e aksesit, afatet e ruajtjes së të dhënave, etj., nëpërmjet sistemit të video survejimit CCTV, në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

5. Gjithashtu, nga verifikimet e kryera në terren, konstatohet se, në ambientet e IML, ka tabela njoftuese mbi prezencën e sistemit të video survejimit CCTV, por tabelat nuk përmbajnë elementët informues sipas modelit standard të miratuar, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave dhe të drejtat që ata gëzojnë, lidhur me përpunimin e të dhënave imazhe/video nëpërmjet sistemit të video survejimit CCTV, në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video survejimit CCTV është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale, të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërmbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

6. Kontrolluesi ka nënshkruar një kontratë shërbimi me shoqërinë “Fastech” sh.p.k., me objekt: “*Mirëmbajtje të sistemit të kamerave dhe web*”.

Nga shqyrtimi i kontratës së mësipërme, rezulton se, në të, nuk janë reflektuar në mënyrë të plotë, rolet, detyrimet dhe përgjegjësitë mes kontrolluesit dhe përpunuesit, sipas parashikimeve të nenit 26 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*”, i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 19*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, të gjitha detyrimet e sanksionuara në nenin 26 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, duhet të jenë të përfshira në kontratën dhe/ose aneks kontratën e hartuar dhe nënshkruar mes kontrolluesit dhe përpunuesit. Çdo kontratë përpunimi, që ka për qëllim delegimin e përpunimit të të dhënave personale duhet të përmbajë dispozita që vendosin rregulla për përpunimin e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi. Çdo kontratë e tillë duhet të parashikojë masat që duhet të marrë përpunuesi për të siguruar e garantuar mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave, si dhe hapat që do të ndërmerren në rast cenimi të të dhënave, me qëllim që të sigurojë paprekshmërinë e tyre, në çdo hallkë të këtij përpunimi.

7. Rezulton se, Kontrolluesi nuk ka marrë masa në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për

mbrojtjen e të dhënave personale, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, bazuar në Kreun IV, të Udhëzimit nr. 47, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura sipas nevojave dhe proceseve të punës së Kontrolluesit dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim ndërgjegjësimin e punonjësve, të cilët për shkak të proceseve të punës, janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare.

Në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesit i është lënë afat të depozitohet pretendimet me shkrim, referuar procesverbalit të hartuar nga ana e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesit e Kontrolluesit, gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në datë 09.04.2025, kanë shprehur dakordësinë lidhur me konstatimet e grupit të hetimit dhe kanë deklaruar angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara.

Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 6, 13, 26, 28, 81, 82, 83 dhe 84 të Ligjit,

#### **REKOMANDOJ:**

1. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje proceset e përpunimit të të dhënave personale, si dhe të marrë masa për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjitha proceset e përpunimit, duke përfshirë edhe ato përmes sistemit të video survejimit CCTV, në përputhje me pikën 5, të nenit 6 të Ligjit. Në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtijshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm;

2. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 28 të Ligjit, të rishikojë rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke parashikuar në mënyrë të detajuar rregulla dhe procedura mbi kategoritë e të dhënave personale që përpunohen, mënyrën e përpunimit, masat e sigurisë dhe konfidencialitetit, afatet e ruajtjes, të drejtat e subjekteve të të dhënave, si dhe përcaktimin e niveleve të aksesit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të IML;
3. Kontrolluesi të marrë masa për hartimin e rregullave dhe procedurave organizative specifike për të dhënat sensitive (*të dhënat gjenetike dhe të dhënat e lidhura me shëndetin*), në lidhje me mënyrën e përpunimit dhe sigurinë e këtyre të dhënave, si dhe të vendosë rregulla të posaçme për mbrojtjen e të dhënave sensitive të personave objekt ekspertimi, në përputhje me nenin 28 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 49 të Komisionerit;
4. Kontrolluesi, të përfshijë në kontratë dhe/ose aneks kontratë, të nënshkuar mes kontrolluesit dhe përpunuesit, detyrimet për përcaktimin e rregullave specifike në lidhje me marrëdhënien mes palëve, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 26 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit;
5. Kontrolluesi, të marrë masa për vendosjen e tabelave informuese në ambientet e survejuara përmes sistemit CCTV, sipas modelit standard të miratuar në Udhëzimin nr. 3 të Komisionerit, me qëllim informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit;
6. Kontrolluesi të marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullave/politikave, për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video survejimit CCTV, nivelet e aksesit, afatet e ruajtjes së të dhënave, etj., sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit;
7. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, në përputhje me proceset përpunuese që ata kryejnë gjatë veprimtarisë së tyre;
8. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
  - (i) vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikën 7 më sipër;
  - (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 1, 4 dhe 5 më sipër;
  - (iii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikën 6 më sipër;
  - (iv) brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 2 dhe 3 më sipër

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

9. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
10. Në rast mospërbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri, bazuar në germën “a”, pika 2, e nenit 83 të Ligjit, paralajmëron kontrolluesit ose përpunuesit se veprimet e përpunimit mund të rezultojnë në mosplotësim të dispozitave ligjore dhe u jep atyre rekomandime lidhur me përputhshmërinë me ligjin. Në rast shkeljesh serioze ose të qëllimshme të dispozitave ligjore, Komisioneri vepron sipas neneve 92, 93 dhe 94 të Ligjit, për vendosjen e sanksioneve administrative në përputhje me nenet përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, në mënyrë të tillë që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 05.05.2025.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**